



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR**

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.2023

**VENDIM**

**Nr.189, datë 25.04.2023**

**PËR  
PËRFUNDIMIN E PROCEDURËS SË LËVIZJES PARALELE NË  
GJYKATËN E RRETHIT GJYQËSOR TIRANË, PËR POZICIONET E LIRA NË  
FUSHËN E TË DREJTËS CIVILE, TË SHPALLURA ME VENDIMET NR. 11, NR.  
12 DHE NR.13 DATË 18.01.2023, PËR KANDIDATIT Z.{...}**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 25.04.2023, pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për tërheqjen e z. {...} nga kandidimi në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me Vendimet nr. 11 nr. 12 dhe nr.13 datë 18.01.2023, të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, përgatitur nga relatori z. Alban {...}, si dhe pasi shqyrtoi kërkesën e kandidatit për tërheqjen nga kandidimi në procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë,

**VËREN**

**I. TË DHËNA MBI KANDIDIMET**

1. Me Vendimin nr.11- nr.24, datë 18.01.2013 Këshilli i Lartë Gjyqësor (më poshtë referuar si Këshilli) ka vendosur hapjen e katërmbëdhjetë procedura të lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë, ndër to, me vendimet nr. 11 deri nr.20 datë 18.01.2023 për procedurën e lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për një pozicion të lirë në fushën e të drejtës civile.
2. Në këto procedura të lëvizjes paralele, afati i kandidimit është përcaktuar dy javë nga dita e publikimit të vendimit përkatës në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor. Njoftimi për hapjen e procedurës është publikuar në faqen zyrtare të internetit të Këshillit, më datë 18.01.2023, duke përfunduar kështu afati i kandidimit më datë 01.02.2023.
3. Brenda afatit të kandidimit për pozicionet e lira nr.11 deri nr. 20 datë 18.01.2023 ka kandiduar edhe z. {...} (më poshtë referuar si kandidati), aktualisht gjyqtar në Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës.

## II. TË DHËNA MBI PROCEDURAT

4. Referuar sa më lartë, kandidati z. {...}, në zbatim të pikës 5 të nenit 43 dhe pikës 6 të nenit 48 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar (më poshtë referuar si Ligji për Statusin), : “*Kandidati nuk mund të kandidojë në më shumë se tre pozicione të lira që janë në proces, qofshin këto procedura ngritje në detyrë apo procedura lëvizje paralele, pavarësisht kohës së shpalljes së tyre, qenies së tyre në të njëjtën gjykatë apo në të njëjtën fushë të së drejtës*”, në komunikimin elektronik të datës 03.02.2023 është njoftuar nga Këshilli të rikonsiderojë aplikimet e tij.

5. Në përgjigje të komunikim elektronik të datës 03.02.2023 me aktin nr. 1005 prot., nga ana e Këshillit, kandidati po në të njëjtën ditë ka konfirmuar marrjen e komunikimit duke përcaktuar vetëm tre pozicione të lira, pa përcaktuar numrat e tyre. Këshilli, mbajtur në konsideratë përcaktimin e Nenit 43/5 të ligjit “Për Statusin” i ndryshuar, sipas të cilit “*...të vlefshme konsiderohen ato të bëra më parë në kohë, ose në rastin e shumë kandidimeve në të njëjtën kohë, ato sipas radhës kronologjike të pozicioneve të shpallura, duke filluar nga ai i shpallur më parë*”, vlerësoi se kandidati kishte aplikuar për pozicionet nr.11, 12, dhe 13, datë 18.01.2023.

6. Në përfundimit të afatit të kandidimit për procedurat e lëvizjes paralele dhe përcaktimit nga kandidatët të interesit për tre procedurat në proces, mbështetur në pikën 9, të vendimit 14/2023, mbi propozimin e Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale, me vendimin nr.77, datë 13.02.2023, Këshilli miratoi listën e kandidatëve që kanë ose mund të kenë dy vlerësime etike dhe profesionale për efekt të kandidimit në procedurat e shpallura të lëvizjes paralele në gjykatat e shkallës së parë. Në këtë listë është përfshirë dhe z. {...}.

7. Me Vendimin nr. 115, datë 13.03.2023, “Për Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Rrethit gjyqësor Tiranë e Durrës, të shpallura me vendimet nr. 11; 12; 13; 14; 15; 16; 17; 18; 19; 20; 21; 22; 23 dhe 24, datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor”, Këshilli ka vendosur:

*I. Fillimin e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit në procedurat e lëvizjeve paralele në Gjykatën e Rrethit gjyqësor Tiranë e Durrës, të shpallura me vendimet nr.11..; ;nr.24 ..., datë 18.01.2023 të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për kandidatët që kanë ose mund të kenë 2 (dy) vlerësime.*

*II. Caktimin e relatorit për secilin kandidat, si më poshtë: ... 14. Për kandidatin z. {...} - relator z. Alban {...}; ... ”.*

8. Më datë 13.03.2023, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Kreun IV dhe V të vendimit të tij nr. 320, datë 17.09.2020, “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve” (më poshtë referuar si Vendimi 320/2020), në rrugë elektronike, kandidati u njoftua: - për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit; - për caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi; - për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtarit tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi.

9. Brenda afatit të përcaktuar kandidati në komunikimin elektronik të datës 15.03.2023,ka konfirmuar se nuk dëshiron të kërkojë përjashtimin e asnjërit prej anëtarëve përfshirë edhe

relatorit por njëkohësisht është shprehur se “..omissis.. dua të vë në vëmendjen tuaj se në kohën kur ushtrija detyrën e gjyqtarit në Gjykatën e Rrethit Vlorë kam gjykuar një çështje civile ku një prej palëve ishte bashkëshortja juaj {...}, e cila e fitoi atë gjykim kundër palës tjetër Stavri Semanjaku..” “..omissis.

9.1 Në vijim Relatori bazuar në komunikimet elektronike me kandidatit dhe informacioneve të grumbulluar nga gjykatat ku ka ushtruar funksionin znj. {...} rezultat i të cilave konstatohet se z. {...} ka qenë palë kërkuese në një proces gjyqësor me znj. {...} si dhe në vështrim të nenit 75 të Ligjit nr.115/2016 “Për Organet e Qeverisjes së Sistemit të Drejtësisë” si edhe germa “E” pika 39 të Vendimit nr.320, datë 17.09.2020 “Për kriteret dhe procedurën e lëvizjes paralele të gjyqtarëve” me kërkesën nr.2003 prot., datë 24.03.2023 i është drejtuar Kryetarit të Këshillit me objekt “*Heqje dorë nga kryerja e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për kandidatin {...}*.”

### **III. TË DHËNA MBI KËRKESËN PËR TËRHEQJEN NGA KANDIDIMI**

10. Gjatë pritjes së trajtimit të kërkesës për heqje dorë të Relatorit të procedurës së verifikimit, kandidati z. {...}, me anë të komunikimit elektronik të datës 30.03.2023 protokolluar në Këshill me aktin nr.2098 prot., ka paraqitur kërkesën për heqjen dorë nga kandidimi për procedurën e lëvizjes paralele për tre pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, duke parashtruar se: “*Ju njoftoj se e tërheq aplikimin tim për lëvizje paralele nga Gjykata e Durrësit për në Gjykatën e Tiranës. Arsyeja e tërheqjes është sepse së fundmi i jam nënshtruar procesit të Vettingut dhe mendoj që aplikimin ta paraqes pasi të përfundojë ky proces*”.

11. Lidhur me vendimmarrjen e Kryetarit të Këshillit nr.02 datë 04.04.2023, sa i përket kërkesës për heqje dorë nga procedura e verifikimit të relatorit për kandidatin z. {...} është vendosur: “*Mbi mos pranimin e heqjes dorë të anëtarit të Këshillit të Lartë Gjyqësor z. Alban {...} nga kryerja e procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për kandidatin z. {...}*” protokolluar me nr. 2003/1 datë 04.04.2023.

12. Në rrethanat sa sipër, përgatitet ky vendim bazuar në pikën 29, Seksioni Ç, Kreun IV, të Vendimit të Këshillit nr.320, datë 17.09.2020 “Për kriteret dhe procedurën e lëvizjes paralele të gjyqtarëve”, ku përcaktohet se: “*Kandidati ka të drejtë të tërhiqet nga kandidimi në çdo kohë, derisa nuk ka përfunduar procedura e lëvizjes paralele, duke depozituar kërkesën e tij me shkrim.*” si dhe në pikën 59, Seksioni C, Kreun V, të Vendimit nr.320/2020 ku përcaktohet se: “*Kur kandidati njofton tërheqjen nga kandidimi, relatori përgatit relacionin ku përshkruhen shkurtimisht veprimet e kryera dhe projektvendimin mbi përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele për atë kandidat, duke e dërguar menjëherë për shqyrtim përpara Komisionit.*”

13. Në Mbledhjen e datës 04.04.2023 Komisioni i Zhvillimit të Karrierës, duke konsideruar të rregullt procedurën e verifikimit të ndjekur për kandidatin z. {...}, si dhe po ashtu, si të qartë dhe të plotë vullnetin e shfaqur nga kandidati për t’u tërhequr nga kandidimi në procedurën e lëvizjes paralele në Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 11, nr. 12 dhe nr. 13 datë 18.01.2023, bazuar në pikën 63, Seksioni Ç, Kreu V, të Vendimit nr. 320/2020, vendosi kalimin e çështjes për shqyrtim në

mbledhjen plenare të Këshillit të Lartë Gjyqësor, për të vlerësuar dhe vendosur ky i fundit për përfundimin e kësaj procedure lëvizjeje paralele për kandidatin z. {...}, për shkak të tërheqjes së tij nga kandidimi.

#### **IV. SHQYRTIMI DHE VLERËSIMI I KËRKESËS SË KANDIDATIT**

14. Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenin 147/a, pika 1, shkronja “a”, është organi kushtetues i ngarkuar, ndër të tjera, edhe me funksionin e lëvizjes paralele të gjyqtarëve, pas ndjekjes së procedurave përkatëse sipas Ligjit për Statusin.

15. Këshilli, në ushtrim të këtij funksioni, realizon procedurat e ngritjes në detyrë në gjykatat e posaçme, duke u mbështetur në Ligjin për Statusin, por edhe në Kodin e Procedurave Administrative, referuar për këtë në pikën 3, të nenit 97, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar (më poshtë si Ligji për Qeverisjen). Sipas nenit 43 të Ligjit për Statusin i ndryshuar, procedura administrative për lëvizjen paralele të gjyqtarëve fillon me kërkesën e tyre për shprehje të interesi. Kjo kërkesë, duke qenë një akt shprehje vullneti, mund të tërhiqet nga kandidati deri sa nuk ka një vendimmarrje nga organi kompetent, çka çon në përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele për atë kandidat. E drejta e kandidatit për t’u tërhequr nga kandidimi buron nga Kodi i Procedurave Administrative, neni 64, pika 2, sipas të cilit: *“Një palë, me anë të një kërkesë me shkrim, mund të tërhiqet tërësisht ose pjesërisht nga procedura administrative dhe të heqë dorë nga të drejtat dhe interesat e saj ligjorë, përveç rasteve kur kjo ndalohet me ligj. Ndryshimi apo tërheqja e kërkesës mund të kryhet në çdo kohë, për sa kohë që organi publik nuk ka marrë një vendim përfundimtar. Pas tërheqjes së një pale, organi publik vendos përfundimin e procedurës administrative. Në këtë rast, organi publik njofton palët e tjera, nëse ka”*. Nga ana tjetër, përfundimi i procedurës administrative për shkak të tërheqjes së kërkesës së palës përcaktohet në dispozitën e sipërcituar, por edhe në nenin 94, pika 1, të këtij Kodi, ku përcaktohet se: *“Si rregull, në procedurën administrative të nisur me kërkesë, organi publik deklaron përfundimin e saj pa një vendim përfundimtar për çështjen, nëse pala që ka paraqitur kërkesën e tërheq atë”*.

16. Rregullimet ligjore si më lart janë reflektuar edhe në aktin nënligjor të miratuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, në Vendimin 320/2020. Kështu, në Kreun IV, Seksioni Ç, pika 29, të tij, përcaktohet se: *“Kandidati ka të drejtë të tërhiqet nga kandidimi në çdo kohë, derisa nuk ka përfunduar procedura e lëvizjes paralele, duke depozituar kërkesën e tij me shkrim”*.

17. Sa sipër, referuar fakteve të rezultuara, konstatohet se kandidati z. {...}, brenda afatit të kandidimit ka paraqitur kërkesën për lëvizjen paralele në Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 11, nr. 12 dhe nr. 13 datë 18.01.2023. Ndërkohë, gjatë zhvillimit të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për ngritjes në detyrë për këto pozicione të lirë, ndërsa Këshilli ende nuk kishte marrë një vendim final, kandidati u tërhoq nga kandidimi në këtë procedurë lëvizjeje paralele, duke parashtruar rregullisht përpara Këshillit një kërkesë me shkrim, në të cilën pasqyrohet në mënyrë të qartë dhe të plotë vullneti i tij për t’u tërhequr nga kandidimi.

#### **V. KONKLUZIONE**

18. Në këto rrethana, pasur parasysh kuadrin ligjor në fuqi, ndërsa rezulton që kandidati z. {...} të ketë shfaqur në mënyrë të qartë dhe të plotë vullnetin e tij për t'u tërhequr nga kandidimi për lëvizjen paralele në Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pozicionet e lira në fushën e të drejtës civile, të shpallura me Vendimet e Këshillit nr. 11, nr. 12 dhe nr. 13 datë 18.01.2023, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se është vendi për të vendosur përfundimin e procedurës së ngritjes në detyrë për këtë kandidat.

### **PËR KËTO ARSYE**

Mbështetur në pikën 2, të nenit 64, të Kodit të Procedurave Administrative, në pikën 3, të nenit 97, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe në nenit 43, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe në vendimin e tij nr. 320, datë 17.09.2020, “Për kriteret dhe procedurat e lëvizjes paralele të gjyqtarëve, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

### **VENDOSI:**

1. Përfundimin e procedurës së lëvizjes paralele në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, për pozicionet e lirë në fushën e të drejtës civile, të shpallura me vendimet nr. 11, nr. 12 dhe nr. 13 datë 18.01.2023, për kandidatin z. {...}, për shkak të tërheqjes së tij nga kandidimi për këto pozicione.
2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet z. {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

### **PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**